

Prot



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 2079 Prot
Shkodër, më 08.02.2019



SHOQATA E ARTIZANËVE
SHQIPTAR

Nr. _____ Prot
Shkodër, më _____

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot me datë ____/02/2019 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi mes palëve:

Bashkia Shkodër me seli ligjore në rrugën "13 Dhjetori", Shkodër, përfaqësuar nga zj. Voltana Ademi në cilësinë e titullarit të institucionit,

dhe

Shoqata e Artizanëve Shqiptar, me seli në lagjen "Mark Lula, rruga "Nënë Klelia Merloni", Shkodër, përfaqësuar nga z. Zef Gjini në cilësinë e kryetarit të shoqatës.

Baza ligjore:

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Ligji nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

VKB nr.1, datë 22.1.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i ndryshuar

Objekti:

Bashkëpunimin me qëllim zhvillimin e biznesit vendor në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të artizanatit dhe produkteve territoriale sipas planvendosjes së sheshit të miratuar.

Duke qenë se:

Bashkia Shkodër ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm nëpërmjet:

- Zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkisë;
- Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor;
- Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar lokal;

- Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit të programeve të zhvillimit ekonomik vendor;
- Mbështetjen për zhvillimin e biznesit;
- Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor.

Shoqata e Artizanëve Shqiptarë është e përbërë nga disa profesionistë artizan që angazhohen në strategjitë dhe nismat për përmirësimin dhe përdorimin e burimeve lokale për zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, për promovimin dhe zhvillimin e artizanatit dhe produkteve territoriale. Kjo gjë synohet të arrihet përmes bashkëpunimit me qeverisjen vendore, nëpërmjet:

- Organizimit të panaiereve,
- Organizimit të aktiviteteve promovuese,
- Organizimit të ekspozitave.

Për sa më sipër, palët bien dakort:

Neni 1

Qëllimi

Mbështetja në organizimin e panaiereve, ekspozitave dhe aktivitete promovuese sipas kalendarit të miratuar për vitin 2019 të Shoqatës së Artizanëve Shqiptar. Përfshirja nga tarifa e përkohshme të Shoqatës së Artizanëve Shqiptar për aktivitet e organizuara apo në partneritet me Bashkinë Shkodër për promovimin e produktit territorial. Shoqata e Artizanëve Shqiptarë është e detyruar të mirëmbajë ambjentet gjatë aktivitetit si dhe në fund të aktivitetit të lihet sheshi në rregull.

Neni 2

Afati i marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet nga palët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, me afat nga momenti i nënshkrimit të saj deri me datë 31.12.2019.

Neni 3

Forma e bashkëpunimit

Koordinimi dhe monitorimi i organizimit të panaiereve vendore.
 Koordinimi i pjesëmarrjes së shoqatës në panaiet që organizohen nga Bashkia Shkodër.
 Regjistrimi dhe miratimi i kalendarit vjetor të panaiereve në Bashkinë Shkodër.
 Vlerësimi i efektshmërisë së panaiereve të organizuara.
 Organizimi i panaiereve dhe ekspozitave tregtare.
 Për panaiet e organizuara nga shoqata në kuadër të kësaj marrëveshje, pjesëmarrja e artizanëve në këto panaiere duhet të jetë pa pagesë ndaj çdo pale të tretë.

Neni 4

Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.



Neni 5
Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi mes palëve do të bëhet sipas mënyrës së parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi, njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të marrëveshjes.

Neni 6
Zgjidhja e marrëveshjes

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 30 ditë përpara.

Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontradite do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshje ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7
Dispozitat e fundit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Kjo marrëveshje u hartuar në tre kopje, nga të cilat njërën e merr shoqata ndërsa dy Bashkia Shkodër.

PËR
BASHKINË SHKODËR

KRYETAR


Voltana Ademi

Konceptoi: E.Baja, M.Fushkaj (Specialist)

Pranoi: B.Mjeda (Përgjegjësi)

Miratoi: M.Gjelluci (Drejtori)

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al


Rishvan Sokoli

PËR
SHOQATËN E ARTIZANËVE
SHQIPTAR

KRYETAR


Zef Gjini



Shoqata e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë
Lagjia: Mark Lula, Rruga: Nene Klelia Merloni, Shkoder
Tel : +355682183325 / +355672301509
www.artizanati.com
Email: artizanati@gmail.com

Shkoder, me 26.12.2018

KËRKESË

1506 27.12.18

Drejtuar: Znj. Voltana Ademi
Kryetare e Bashkisë Shkodër

Tema: Kalendar i vjetor i panairove të planifikuara për vitin 2019

Shoqata e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë, duke vazhduar në frymën e bashkëpunimit të frytshëm që ka pasur me Bashkinë Shkodër gjatë vitit 2018, po paraqesim për miratim grafikun e panairove për vitin 2019. Organizimi i panairove do të jetë kryesisht me rastin e festave, sipas këtij grafiku:

Muaji v.2019	Datat	Evenimenti	Vendi
Shkurt	16-17	Gjatë Karnavaleve.	Pedonale "Kolë Idromeno"- Shkodër
Mars	7-9	Festa e mësuesit dhe gruas	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Mars	14-16	Dita e Verës.	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Prill	19-20	Festa e Pashkëve	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Maj	4-6	Festa e luleve.	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Qershor	3-4	Festa e Bajramit.	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Qershor	10-12	Dita e Artizanatit.	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Qershor	18-19	Dita e Liqenit.	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Korrik	6-7, 13-14, 20-21, 27-28	Panair Veror	Velipojë
Gusht	3-4, 10-11, 17-18, 24-25	Panair Veror	Velipojë
Gusht	30-31	Panair Veror per Emigrantat	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Shtator	27-29		Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Tetor	25-27		Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Nëntor	28-30	Festat e Nëntorit.	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Dhjetor	3-5	Festa e Shënkollit	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër
Dhjetor	15 - 31	Festat e Fundvitit.	Pedonale "Kole Idromeno"- Shkodër

65 ditë

Shënim: Shoqata e Artizanëve është e gatshme të organizojë panairove dhe ekspozita për rastet e tjera ku Bashkia Shkodër mund të planifikojë ceremoni festash etj.
Do të organizohen edhe panairove tjera që nuk mund të planifikohen data të sakta që tani.

Mbetemi me shpresë të miratimit nga ana e juaj, të Grafikut të Panairove për vitin 2019.

Për Shoqatën e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë

Kryetari:
Inxh. Zef Gjini

